


ARDHMËRIA JONË



ELEMENTET E DEMOKRACISË

ERINA (10), BEHARE (10), BLENDRIT (10), ERJON (9), EDBER (10), ERA (10), SUELA (10),

LEART HO. (10), LEART HA. (10)



Ne jemi gazetarët që e shtypëm këtë gazetë dhe ne duam t'iu tregojmë elementet e demokracisë

Demokracia është qeverisje nga populli, dhe ajo rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Gjuha greke flitet në Greqi, dhe kryeqyteti i saj është Athina. Aty ka lindur demokracia, në vitin 507 para erës sonë. Në demokraci ka tolerancë, që do të thotë se ne respektojmë njëri-tjetrin. Elementet e tjera të demokracisë janë solidariteti dhe dashuria për tjetrin, ku çdo njeri e duam si vëlla dhe si motër.

Të gjithë jemi të barabartë, dhe duhet të kemi respekt për të gjithë, pavarësisht racës, besimit, apo fesë. Pjesë e demokracisë është edhe Kuvendi, vendi ku nxirren ligjet e një vendi. Ligjet bëhen nga deputetët dhe duhet të përputhen me Kushtetutën. Respektimi i ligjeve është një nga elementet më të rëndësishme të demokracisë. Një nga ligjet tona është të mos e ndo-

tim ambientin dhe këtë ligj ne duhet ta respektojmë. Ligjet duhet respektuar edhe në komunikacion. Kur në semafor është drita e gjelbër, atëherë ne mund të kalojmë rrugën, por kur është drita e kuqe atëherë nuk është e drejtë që të kalojmë rrugën. Ne duhet t'i respektojmë ligjet, dhe nëse nuk e bëjmë një gjë të tillë, ne mund të dënohemi nga gjykata. Duke respektuar ligjet ne ndjehemi më të sigurt në cilindo vend që jemi.



Barazia gjinore e ilustruar



Autorët e artikullit

POPULLI E KA PUSHTETIN

BLERTON (10), VALMIR (10), BLERON (11), BLEONA (10), RINOR (11), GENIZA (11), ADEA (10), BLEONA (10)



Në këtë artikull do të mësoni se si populli vendos për të ardhmen e vet

E ardhmja e vendit varet nga populli përmes pjesëmarrjes aktive në zgjedhje. Të drejtë vote kemi që nga moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të rritur dhe jemi më të pjekur. Përmes zgjedhjeve, populli i zgjedh deputetët, të cilët marrin vendime të rëndësishme dhe të cilat kanë rol të rëndësishëm për ne. Deputetët miratojnë ligjet për arsim, mjekësi, ekonomi, etj. Në Kosovë ekzistojnë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale.

Zgjedhjet bëjnë pjesë në demokraci, sepse përmes tyre secili qytetar e shpreh mendimin e vet lirshëm dhe kështu secili vendos për të ardhmen e popullit të tij. Prandaj, vota bën ndryshime në vend.



Autorët e artikullit






Bashkëpunimi në grup



Ilustrim nga gazetarja Altina



Mos ta ndotim ambientin, ta mbrojmë atë




Kontributi i gazetarëve të rinjë




Të gjithë së bashku për një artikull të mirë



Ilustrim i një ambienti të pastër




E drejta e shkollimit



Gjatë shkruarjes së artikullit

QYTETARË TË NDERSHËM

ALTINA (10), ERLISA (10), ERDA (10), GENTRITI (10), ARLINDI (10), ENSAR (11), RREZART (11),
SHKURTA (10)



Qytetarë jemi të gjithë ne pa dallime, sepse ne jemi pjesë e demokracisë

Ne jemi të lumtur dhe të gëzuar që çdo njeri i ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta, dhe të gjithë jemi të barabartë me njëri-tjetrin. Qytetarët në demokraci nuk bëjnë dallime në mes vete në bazë të racës, gjinisë, kombit, moshës, fesë, etj. Nëse një njeri do të jetë një qytetar aktiv, ai duhet të punoj për vendin e tij dhe t'iu ndihmoj njerëzve të cilët kanë nevojë për ndihmë. Neve si të gjithë qytetarëve të tjerë, demokracia na mundëson të drejta dhe liri.

Demokracia është formë e udhëheqjes, ku ne si qytetarë vendosim vetë për të ardhmen e shtetit tonë. Disa të drejta tona janë: të shkollohemi, të ushqehemi, të flejmë, të shoqërohemi me shokët dhe shoqet e klasës, të jemi të shëndetshëm, të pastrohemi, të qeshim, të flasim, të argëtohemi në kohën e lirë, etj. Ndërsa, disa nga përgjegjësitë tona si qytetarë janë: të mos qeshim me mendimet e të tjerëve, t'i ndihmojmë të moshuarit, t'i respektojmë të tjerët, t'i bëjmë detyrat e shtëpisë, t'i dëgjojmë prindërit tanë, ta dëgjojmë mësuesen, ta mbajmë ambientin pastër, t'i respektojmë ligjet, ta duam njëri-tjetrin, të mos grindemi me shokët dhe shoqet e klasës, etj.

Pra, çdo qytetar i ka të drejtat dhe përgjegjësitë e tij që duhet t'i kryej, e të gjitha këto na i mundëson demokracia.



Ne kemi të drejtë që të shkollohemi



Jemi qytetarë të përgjegjshëm



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë